



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES**

**I.Numër:01/016/04/124405, datë:28. Dhjetor 2022.**

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2.pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431, dt.30 Shtator 2020, në propozim të kryetarit të Komunes dhe Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28. Dhjetor 2022, merr:

**V E N D I M**

**Nr. 87/2022**

**MBI MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TE PUNES SE AUDITORIT TE BRENDSTEM PER VITIN 2023**

1. MIRATOHET Plani Vjetor i Punës së Auditorit të Brendshëm Pejë, për vitin 2023 në tekst siç u është propozuar anetarve të Kuvendit me material për takim.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Vjetor i Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2023.
3. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në Ueb Faqen zyrtare të Komunës.

**KRYESUESI I KUVENDIT,  
z. Rexhep Kurtbogaj**



**Vendimi ti dërgohet:**

1x1 Kryetarit të Komunës,  
1x1 Kryesuesit të Kuvendit,  
1x1 Auditorit të Brendshëm.  
1x1 Arkivë.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

# PLANI VJETOR

## I

Njesisë së Auditimit të Brendshëm

NË KOMUNËN E PEJËS

PËR VITIN 2023

Pejë, Dhjetor 2022

## **Përmbajtja**

- I. Hyrja
- II. Aktivitetet për arritjen e objektivave strategjike të AB
- III. Detyrat e auditimit
- IV. Linjëzimi i detyrave të planifikuara të auditimit me strategjinë e auditimit
- V. Alokimi i burimeve

## I. HYRJE

Ky Plan Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për vitin 2023 dhe miratohet nga Kryetari i Komunës së Pejës. Ai përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit. Detyrat e auditimit për vitin 2023, ndahen në bazë të burimeve njerëzore që ekzistojnë në NJAB. Plani Vjetor duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që të pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në organizatë apo në mesin e anëtarëve të NJAB-së, dhe çdo detyrë shtesë që propozohet nga udhëheqësi i organizatës. Çdo ndryshim i Planit Vjetor do të aprovohet nga Kryetari i Komunës.

## II. AKTIVITETET E NJAB PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Në vitin 2023 NJAB planifikon realizimin e detyrave dhe aktiviteteve si në vijim, për arritjen e objektivave të përshkruara në Planin Strategjik:

Nr	Objektivi strategjik	Aktivitetet për arritjen e objektivit	Detyrat
1	Përmirësimin e të kuptuarit të funksionit të kontrollit të brendshëm.	Rishikimi për të vlerësuar të kuptuarit e funksionit të mjedisit të kontrollit të brendshëm nga menaxhmenti.	Shërbime sigurie
2	Të ndihmohet organizata që të zhvillojë procesin e menaxhimit të rrezikut.	Rishikimi i vlerësimit që të zhvillojë proceset për menaxhimin e rrezikut.	Shërbime sigurie
3	Ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e rrezikut në organizatë.	Rishikimi i vlerësimit për ngritjen e vetëdijes në menaxhimin e rrezikut në organizatën buxhetore.	Shërbime sigurie
4	Asistencë për zhvillimin e monitorimit në organizatë.	Rishikimi i vlerësimit për asistencë në zhvillimin e monitorimit në organizatën buxhetore.	Shërbime sigurie

### III. DETYRAT E AUDITIMIT

#### 3.1. Detyrat e pa zbatuara nga viti i kaluar

Nuk ka detyra të tilla.

#### 3.2. Auditimet e njësive/sistemeve strukturore që janë duke u zhvilluar

Në proces të përfundimit të auditimit është Drejtoria për Buxhet dhe Financa me ç'rast edhe do të kompletohet plani për vitin 2022. Sfidat në realizimin e planit vjetor ishin të lidhura me kushtet e krijuara nga pandemia dhe do të vazhdojnë edhe për këtë plan.

#### 3.3. Llojet e detyrave të auditimit

Indeksi i rrezikut	Lloji i detyrës	Njësia strukturore	Objektivi i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Periudha
2.33	DSHS 2301	Zbatimi dhe respektimi i procedurave të prokurimit	Të jap një siguri të arsyeshme mbi zbatimin e procedurave dhe ligjit për prokurim	Zyra e Prokurimit	Janar - Mars
2.5	DSHS 2302	Shpenzimet dhe respektimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi	Të japë siguri së shpenzimet janë reale në bazë të pasqyrave financiare dhe së janë respektuar rregulloret dhe ligjet në fuqi	Drejtoria për Arsim	Janar -Mars
2.33	DSHS 2303	Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve të ndërlidhura.	Të japë siguri se janë respektuar ligjet dhe rregulloret e ndërlidhura gjatë zbatimit të detyrave	Drejtoria për Punë Inspektuese	Prill-Qershor
2.0	DSHS 2304	Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi	Të jap siguri së janë respektuar ligjet dhe rregulloret e ndërlidhura	Drejtoria për administratë dhe personel-Burime njerëzore	Prill-Qershor
2.17	DSHS 2305	Menaxhimi i të hyrave dhe shpenzimeve .	Dhënia e sigurisë në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.	Drejtoria për Shëndetësi	Korrik-Shtator
1.83	DSHS 2306	Menaxhimi i shpenzimeve	Të japë siguri së menaxhimi i është i drejtë për të gjitha kategoritë	Drejtoria për Mirqenie Sociale	Korrik Shtator
1.67	DSHS 2307	Menaxhimi i të hyrave dhe respektimi i ligjeve në fuqi	Të jap siguri së mbi menaxhimin e drejtë të të hyrave dhe së janë respektuar ligjet dhe rregulloret e ndërlidhura gjatë shpenzimit të buxhetit.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Tetor Dhjetor
2.33	DSHS 2308	Menaxhimi i sektorit të tatimit në pronë	Të japë siguri mbi menaxhimin e drejtë të të hyrave	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Tetor Dhjetor

#### IV. RADHITJA E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA TË AUDITIMIT ME STRATEGJINË E AUDITIMIT

Detyrat e planifikuara për vitin 2023 janë paraqitur në tabelën vijuese:

Nr.	Njësia e synuar e auditimit	Indeksi i rrezikut	Prioriteti	E planifikuar për vitin 2023	Nr. i detyrës së auditimit
A.	B.	C.	D.	E.	F.
1	Zyra e Prokurimit	2.33	L	X	DSHS 2301
2	Drejtorati për Arsim	2.5	L	X	DSHS 2302
3	Drejtorati për Punë Inspektuese	2.33	L	X	DSHS 2303
4	Drejtorati për administratë dhe personel-Burime njerëzore	2.0	M	X	DSHS 2304
5	Drejtorati për Shëndetësi	2.17	M	X	DSHS 2305
6	Drejtorati për Mirqenie Sociale	1.83	M	X	DSHS 2306
7	Drejtorata për Zhvillim Ekonomik	1.67	U	X	DSHS 2307
8	Drejtorata për Buxhet dhe Financa	2.5	L	X	DSHS 2308

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2023 përputhen me strategjinë e aprovuar të auditimit. Raporti në mes të detyrave të planifikuara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor tregohet në tabelë dhe është si vijon:

Llojet e detyrave të auditimit	Numri i detyrave për vit	Numri i përgjithshëm i ditëve për person	Detyrat e auditimit sipas Planit Strategjik	Zbatimi i planit i shprehur në përqindje
Detyrat për shërbimet e sigurisë				
Rrezik i lartë	4	120	4	100%
Rrezik i mesëm	3	60	3	100%
Rrezik i ulët	1	17	1	100%
Përcjellja e rekomandimeve		7		
Detyrat për shërbimet këshilluese		20		

## V. PROKURIMI I BURIMEVE DHE NDARJA E DETYRAVE TË AUDITIMIT


### 5.1. Koha efektive e punës

Koha efektive e punës kalkulohet për secilin auditor nga NjAB-ja në pajtueshmëri me strategjinë e auditimit si vijon:

### 5.2. Orari kohor për detyrat e auditimit dhe ndarja e punonjësve të NjAB-së në detyrat e auditimit.

Tre-mujori	Detyra e Auditimit	Prioriteti i njësishë së synuar të auditimit	Ditë për person	Drejtori i njësishë	Udhëheqësi i ekipit	Anëtarët e ekipit		
I	1	DSHS 2301	Rrezik i lartë	30		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	Emri
	2	DSHS 2302	Rrezik i lartë	30		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
II	3	DSHS 2303	Rrezik i lartë	30		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
	4	DSHS 2304	Rrezik mesëm	20		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
III	5	DSHS 2305	Rrezik i mesëm	20		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
	6	DSHS 2306	Rrezik i mesëm	20		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
IV	7	DSHS2307	Rrezik i ulët	17		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
	8	DSHS 2308	Rrezik i lartë	30		Senad Adrovic	Lavdim Lajqi	
Planifikimi strategjik dhe vjetor				7				
Punë tjera të NjAB-së				20				
Numri i përgjithshëm ditëve për aktivitetet e auditimit për NjAB				224				

Kryetari i K.K. Pejë



UD i Drejtorit të NjAB-së

